



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr. 180, datë 29.04.2021**

**PËR**  
**FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KRITEREVE**  
**LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË GJYKATAT**  
**E APELIT DURRËS, KORÇË DHE VLORË, PËR POZICIONET E LIRA TË**  
**SHPALLURA ME VENDIMET NR. 129, NR. 132 DHE NR. 135, DATË 01.04.2021,**  
**TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, shkronja “ç”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 48, pika 7, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni A, pika 1, shkronja “c” dhe pika 2, si dhe në Kreun VI, Seksioni B, pika 7, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pas shortit të hedhur,

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatat e Apelit Durrës, Korçë dhe Vlorë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 129, nr. 132 dhe nr.135, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë:

- |   |                              |
|---|------------------------------|
| 1. Për kandidaten znj. Atalanta Zeqiraj | - relator znj. Marçela Shehu |
| 2. Për kandidaten znj. Diamela Goxha    | - relator z. Alban Toro      |
| 3. Për kandidatin z. Dritan Hasani      | - relator z. Alban Toro      |
| 4. Për kandidaten znj. Zhaneta Pira     | - relator z. Alban Toro      |

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**